



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

### **Nr. 67**

Datë: 15. 10. 2021. Ora: 14:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
  - 1. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

#### **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për mbushje të telefonisë mobile për menaxherët e QV dhe ekupeve mobile, për zgjedhjet lokale 2021.

- 2. Të ndryshme.**
- 

### **1.Hyrje z. Kreshnik Radoniqi Kryesues i mbledhjes të KQZ-së**

**Kreshnik Radoniqi:** E hapim mbledhjen e 67-të të KQZ-së, Komisioni është në përbërje jo krejt të plotë. Ilir Gashi mungon edhe ka njoftuar që nuk mund të marrë pjesë në mbledhjen e sotme , anëtarët tjerë janë të gjithë prezentë, sipas rendit të ditës që keni përpara i kemi aktivitetet e zyrës , raportet e këshillave

të KQZ-së, Këshilli për Buxhet dhe Financa dhe nëse ka dikush diçka në të ndryshme, a pajtoheni me rendin e ditës a keni për të shtuar diçka ?

**Alim Rama:** Në mbledhjen e fundit, kur e kemi trajtuar pikën e ud. Zëvendës kryshefit, dhe ka mbetur që me e trajtuar në Këshillin për Personel por pasi Këshilli për Personel nuk ka marrë kurrfarë informate prej sekretariatit kështu që unë rekomandoj që kjo të trajtohet te pika e pestë .... e fundit, se ashtu bëhet e fundit e pestë

**Kreshnik Radoniqi :** Atëherë, a mundemi me e votuar rendin e ditës me këtë plotësim ? Kush është për ?

Unanimisht, aprovohet rendi i ditës.

## **2.Aktivitetet e ZRPPC-së:**

**Ylli Buleshkaj:** Vetëm si informatë, shumë shkurtë për shkak që nga mbledhja e fundit nuk është se ka ndodhë shumë gjëra ! Por ajo që ka ndodhë, është që raportet financiare nga auditimi që janë bërë të partive politike, janë përfunduar nga auditorët, janë dërguar në kuvend deri me 25 tetor kur do të arrijnë te ne. Ne, ashtu i kemi pranuar informatat nga kuvendi i Kosovës pastaj do ti marrim edhe vendimet tjera si KQZ, dhe do të vijnë rekomandimet para jush qoftë ato marrje e masave për partitë që nuk i kanë plotësuar të gjitha kushtet të raportimit; Po ashtu edhe publikimi i tyre si e kërkon ligji në uebfaqe të këtyre raporteve të audituara. Pika tjetër të cilën shumë shkurtë deshta ta përmendi, është se ne i kemi pranuar të gjithë bexhat e vëzhguesve të cilët janë në shpërndarje kanë mbetur tash vetëm disa media të huaja, dhe disa OJQ vendore, ndërsa pjesë tjera të partive politike janë shpërndarë partive politike po ashtu të organizatave ndërkombëtare janë shpërndarë fillimisht si prioritet tash kanë mbetur organizatat vendore dhe mediat kryesisht të cilat kanë afat sot më së largu nesër në qoftë se vjen dikush ti pranojë

**Arianit Elshani:** Nuk e kuptova këtu te raportet e audituara, se më intereson të di se kur do të vijnë në KQZ deri me datën 25 apo ?

**Ylli Buleshkaj :** Kemi kontaktuar me kuvendin e Republikës së Kosovës me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike të cilët kanë qenë përgjegjës për kontraktimin e shërbimeve ata i kanë pranuar dje raportet po tash është procesi i pranimit zyrtarisht si e kanë ata kontratë me këtë operatorin ekonomik edhe më lajmëruan se ne te ju nuk mundemi me i sjellë para të 25tit do të thotë që më 25 tetor pritet që ne ti pranojmë këto raporte të audituara

**Arianit Elshani:** Edhe një kërkesë unë jam njoftuar nga PDK se ka disa probleme lidhur me shpërndarjen e bexhave mund të jetë problem vetë i menaxhimit brenda administratës të subjektit mirëpo mendoj që ju e di që e keni kontaktin e vazhdueshëm me cilindo subjekt politik prandaj mendoj që është mirë ti njoftoni ata në momentin kështu jam njoftuar nga një subjekt tjetër politik që ka disa bexha të vëzhguesve të PDK-së, prandaj është mirë që ju të ftoni të gjitha subjektet politike dhe të ju njoftojnë juve për çdo bexh që kanë të një subjekti tjetër politik sepse mund të ndodhë që ka pasur ndonjë ngatërrim dhe të njëjtat pastaj ti shpërndajnë mes vete ose në ZRPPC te ju dhe ju ti shpërndani sërish te subjektet pra që të menaxhohet në tërësi siç është më së miri ky proces i menaxhimit të bexhave

**Ylli Buleshkaj:** Si zyrë nuk kemi pranua ndonjë informatë që ka pranua dikush nga një subjekt tjetër. Kemi pranuar informata për disa mungesa të cilat pasi janë sqaruar se shumica e rasteve nuk kanë qenë mungesa kanë dalë të gjitha nga zyra jonë, pastaj mund të ketë ndonjë ngatërresë në shpërndarje , këtë vit mundem me thënë kemi qenë shumë me fat me kontraktorin ka qenë i mrekullueshëm...

**Sami Kurteshi:** Atëherë, veç një pyetje krejt të përgjithshme. Ne, kemi çështje tjera por, dua të pyes vërtetë, se a ka çfarëdo ngecje, çështje që duhet të zgjidhet shumë shpejtë, apo gjithçka është sipas planit, nuk ka sipas juve asnjë pengesë d.m.th., për ditën e zgjedhjeve...?

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit për pyetjen, dhe mund të ju konfirmoj se tash i kemi marrë të gjitha artikujt me furnizime dhe i kemi në depon qendrore të KQZ-së. Sot e nesër, do të bëhet shpërndarja e materialit, pra e materialit sensitiv, e aty hyjnë edhe fletëvotimet dhe materialet tjera të ndjeshme; Do të jenë edhe formularët zgjedhorë të cilët, do të shpërndahen nesër nëpër secilën komunë kështu që në aspektin e furnizimeve dhe distribuimit nëpër komuna, nuk kemi ngecje në asnjë aspekt. Kemi pasur mbingarkesë në prodhimin e id bexhave mirëpo, po më duket që jemi liruar tash dhe gjërat po rregullohen...Nuk është raportuar deri më tani se, a kemi ndonjë problem d.m.th., të gjithë artikujt i kemi në depo dhe shpërndarjen do ta bëjmë nesër sipas planit operacional...

**Alim Rama:** Ndërlidhet që të përfshihet në raportin nesër, se ka qenë një mbledhje të Këshillit për Personel por për shkak të mbingarkesës dje, nuk është mbajtur. Kështu që kisha kërkuar prej sekretariatit të japë raportin detal të implementimit të planit të personelit d.m.th., të gjitha fazat pasi besoj që tash është përfunduar komplet rekrutimi, duke përfshirë edhe QNR-në...

## **Raport i Këshillave të KQZ-së**

### **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për mbushje të telefonisë mobile për menaxherët e QV dhe ekipeve mobile, për zgjedhjet lokale 2021:

**Gordana Llaban:** Kemi mbajtur mbledhjen e këshillit, dhe kemi shqyrtuar katër pika të rendit, por për ju është me rëndësi pika e tretë e takimit: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për mbushje të telefonisë mobile për menaxherët e QV dhe ekipeve mobile, për zgjedhjet lokale 2021. KQZ, veç i ka paraparë mjetet për këtë pjesë të shpenzimeve: 17.700 euro. Është tabela, dhe mund t'i shihni të dhënat...

Me këtë rast, parashihen të shpenzohen për të dy raundet: 10.870 euro... Ne rekomandojmë për miratim...

**Sami Kurteshi:** Veç një pyetje e kam për sqarim. Kjo shifër këtu 10.870 euro, është e paraparë për të dy raundet, a ka qenë e paraparë edhe më shumë ? .... Tash kjo është shifra përfundimtare...!

**Florian Dushi:** Nuk dëgjohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka tjetër e hedhim në votim. Kush është për miratimin e këtij vendimi ?

Me 10 vota për, miratohet vendimi për mbushje të telefonisë mobile për menaxherët e qendrave të votimit dhe ekipeve mobile për zgjedhjet lokale 2021

**Burim Ahmetaj:** Ju kam shkruar imelë ASHI-së po ashtu kam komunikuar me telefon me drejtorin që është për këto shërbime mirëpo më tha duhet me e adresu në qeveri se qeveria ka marrë vendim që të reduktohen në masë të madhe kartelat VIP mirëpo ia sqarova që roli dhe përgjegjësia e KQZ-së si trup kolegjal është e njëjtë të 11 anëtarët e KQZ-së janë të njëjtë kështu që nuk mundemi me e dallua njërin prej tjetrit në këtë rast me id kartela nuk mundet me u dallua asnjëri prej tjetrit kështu që tha do ta shqyrtojmë do ta dërgojmë në qeveri dhe do të na japin përgjigje...

**Sami Kurteshi:** Në rregull është se, ne i kemi përdorur ato kartela, si kemi përdorë sidoqoftë...Unë mendoj se, nëse paska një vendim të qeverisë sipas kësaj që e kuptova unë, mendoj se ata duhet ta dërgojnë atë vendim të shkruar të qeverisë dhe, nëse ne kemi interes, ne mundemi me e kundërshtuar ligjërisht por s'ka vendim të qeverisë me gojë... Unë jam shumë i lumtur që është qeveri e Vetëvendosjes, nuk e kam atë problem veç kjo qeveri nuk mundet me marrë vendim me gojë, dhe unë jam i interesuar me e pa edhe me e kundërshtua ligjërisht, nëse dikush thotë se ka marrë vendim dhe ai vendim është i pavlefshëm, i kundërligjshëm...

Nuk jemi Banana Republikë...!

**Florian Dushi:** Më së pari neve nuk na është thënë që në një fakt me dorëzimin e kartelave tona apo zëvendësimin e tyre me të rejat anëtarët e KQZ-së statusi i të cilëve rregullohet me kushtetutë dhe me Ligjin e Zgjedhjeve të Përgjithshme do të trajtohen njëjtë - ngjashëm sikur mijëra shërbyes civil në Kosovë , unë nuk besoj më së pari që ka vendim të qeverisë fare sepse unë konsideroj që cilado qeveri është e vetëdijshme që nuk mundet me ndërhy dhe me përcaktua statusin e anëtarëve të KQZ-së prandaj në këtë drejtim unë mendoj që KQZ duhet të marrë vendim se çfarë lloj id do të prodhojnë se ata veç prodhojnë id ASHI-ja , çfarë lloj id duhet me pas anëtarët e KQZ-së dhe ne nuk mundemi qeverinë me e detyruar as ti bëjë VIP por nuk mundet qeveria as me na i hequr nëse ne vendosim me i pas sepse jemi të ndara pushtete në njëfarë forme organ i pavarur , unë nuk besoj që qeveria merr ndonjë vendim me thënë hiqjani anëtarëve të KQZ-së , hiqjani gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese , hiqjani Ombuspersonit sepse ata janë plotësisht të vetëdijshëm që ajo nuk është punë e tyre prandaj mendoj që këtë ne mundemi me e zgjidhë vetëm në një formë duke marrë vendim këtu që gjithë anëtarët e KQZ-së , Kryesuesi do të pajisen me këtë lloj të ID-ve , unë e kuptoj qeverinë edhe nëse ka një politikë të tillë të reduktimit të këtyre kartelave unë e di që kjo çështje ka eskaluar pak në të kaluarën në kuptimin e pajisjes bash të secilit mirëpo nuk mundet me ia filluar prej anëtarëve të KQZ-së sepse nuk kanë të drejtë prandaj unë konsideroj që ne duhet me e nxjerrë një vendim këtu edhe me ia dërgu ASHI-së se ata vetë i prodhojnë edhe ne i tregojmë çfarë tip të id-ve dëshirojmë me i pas...

**Kreshnik Radoniqi:** E kam vetëm një pyetje: A ka rregullore atje ? A ekziston rregullorja për id kartela se, edhe unë p.sh., kartelën e gjyqtarit e kam njëjtë si tash që ua kanë pru edhe gjyqtarët dhe prokurorët tjerë. I kanë id e njëjta dhe është një prodhues...

**Florian Dushi:** Departamenti jonë ligjor, le t'i marrë dhe t'i analizoj ato rregullore edhe le të vijë me një përfundim te ne, dhe ne mandej e shohim si duhet të veprojmë më tutje...

**Rifat Krasniq:** A bën ne këtë propozim, këtë vendim edhe me shtuar pasoshat, me qenë diplomatikë se kur zëvendësministrat e kanë pasoshat diplomatikë, pse ne 11 anëtarë s'kemi, zëvendësministrat 70-80 zëvendësministra kanë të drejtë me pas, a kemi të drejtë edhe ne...?

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Sami Kurteshi, Cemajl Kurtis, Alim Rama, Florian Dushi, dhe Burim Ahmetaj.

**Kreshnik Radoniq:** Atëherë, nëse nuk ka diçka tjetër po mendoj që përmes zyrës ligjore Burim mundem me shikuar punën e id kartelave dhe të pasaportave etj., edhe e bijmë një përfundim. Pika e fundit...! Alimi e ngriti çështjen për zëvendëskryeshefit, të mërkurën kur e patëm mbledhje e parafundit...

*P.s. Pika e radhës lidhur me diskutimin për pozitën e Zëvendëskryeshefit, është e mbyllur...*